



Komunikatë për shtyp e KQZ-së

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të plotë për angazhimin e Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë dhe Ambasadorit Dell, dhënë KQZ gjatë tërë procesit organizativ të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2009. Përkrahja e vazhdueshme dhe permanente e z. Dell, është dhe mbetet inkurajim i plotë për punën tonë të metejme, pra të KQZ-së gjatë të gjitha fazave të ndieshme të këtij procesi në implementimin e plotë të vullnetit të lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Konsultat profesionale dhe përgjithsishtë këshillimeve të ekspertëve që na janë dhënë, jemi mirënjohës dhe kemi respekt të fuqishëm për z.Dell dhe stafin e Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë. Në këtë proces të ndieshëm, do të jemi të palëkundshëm në shkëmbimin e të gjitha ekspereincave dhe këshillave reciproke për të tejkaluar sfidat eventuale në dobi të demokracisë dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Deklaratat dhe komentet e disa medimeve të shkruara, nuk përkasin me realitetin objektiv të angazhimit të KQZ-së. Ne edhe më tutje do të mbetemi besnik në implementimin e vullnetit të lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës, në zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjin e Përgjithshëm për Zgjedhjet.